



INFORMACION MBI TREGUESIT KYÇ TË PERFORMANCËS KPI 2025



Adresa: "Identitek" SH.A, Rruga "Xhanfize Keko", Ndërtesa 111, Hyrja 1, Tiranë, Albania

NIPT: M316130430; www.identitek.al; info@identitek.al.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	2
2. KPI 1-3 Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e dokumenteve biometrike brenda dhe jashtë vendit (Letërnjoftim Elektronik, Pasaportë, dokumenti biometrik për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri)	2
3. KPI 4. Përmirësimi i bazës ligjore për të përmirësuar e standartizuar praktika	3
4. KPI 6. Marrja dhe ruajtja e certifikimit ISO (Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim)	4
5. KPI 7. Numri i projekt propozimeve të hartuara me synim zhvillimin e aplikacioneve apo produkteve të reja	4
5.1 Projekti “Identiteti Digjital për Shtetasit Shqiptarë”	4
5.2 Projekti “Karta e Identitetit e Shpejtë”	5
5.3 Projekti “Kuponi Elektronik E-Kupon”	5
5.4 Projekti “Gjurmo Dokumentin e Identifikimit”	5
5.5 Projekti “Nënshkrimi Elektronik E-Signature”	5
5.6 Projekti “Shërbimi i Klientit”	6
6. KPI 8. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Drejtorinë së Çelësave Publike (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, (ICAO).	6
7. Përmbledhje e Hartës Konceptuale të Indikatorëve për Vitin 2025	7

1. HYRJE

Ky dokument, është një përmbledhje e statusit dhe arritjeve të IdentiTek SHA për Treguesit Kyc të Performancës (KPI) për vitin 2025. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë ka miratuar Treguesit Kyc të Performancës në përputhje me parashikimet statutores.

2. KPI 1-3 Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e dokumenteve biometrike brenda dhe jashtë vendit (Letërnjoftim Elektronik, Pasaportë, dokumenti biometrik për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri)


Shoqëria vazhdon të ruajë një standard të lartë për ofrimin e shërbimit në kohë e në mënyrë profesionale. Këtu përfshihet respektimi i afateve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike si edhe ofrimi i shërbimeve me nivel të lartë ndaj qytetarëve gjatë çdo procesi aplikimi për pajisjen me dokumente biometrike.

Gjatë vitit 2025, IdentiTek ka prodhuar dhe shpërndarë në kohë të gjitha dokumentet biometrike, pasaportat dhe letërnjoftimet elektronike për shtetasit shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, janë prodhuar brenda afateve kohore të gjitha Lejet e Qëndrimi për shtetasit e huaj me banim në Shqipëri.

Gjatë vitit 2025 në Shqipëri janë lëshuar **462,965** dokumente biometrike sipas ndarjes së mëposhtme.

Lloji i dokumentit	Viti 2025	%
Letërnjoftim me procedurë normale	141,890	31%
Letërnjoftim me procedurë të shpejtë	36,230	8%
Pasaporta procedurë normale	193,765	42%
Pasaporta me procedurë të shpejtë	75,854	16%
Leje Qendrimi	15,226	3%
Total Dokumenteve Biometrike	462,965	

Dokumente biometrike 2025



3. KPI 4. Përmirësimi i bazës ligjore për të përmirësuar e standartizuar praktika

Në kuadër të realizimit të KPI-së, shoqëria **Identitek SHA**, gjatë vitit 2025, ka ndërmarrë dhe planifikuar një sërë nismash ligjore dhe rregullatore, me qëllim forcimin e kuadrit normativ që rregullon ushtrimin e veprimtarisë së saj, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe përshtatjen me zhvillimet teknologjike dhe institucionale në fushën e identitetit dhe dokumenteve biometrike.

Këto nisma synojnë, ndër të tjera, standardizimin e praktikave administrative, rritjen e sigurisë juridike, përmirësimin e kushteve të punës për punëmarrësit, si dhe rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit ndaj qytetarëve, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë këto nisma:

1. Shoqëria ka ndërmarrë nismën për konkretizimin e Akt-Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Insitucionet Vendore dhe Qëndrore për zyrat e aplikimit, të cilat ofrojnë shërbim për qytetarët në ambientet e këtyre institucioneve.
Kjo nismë synon:
 - përmirësimin e kushteve të punës për punëmarrësit e shoqërisë; dhe
 - përmirësimin e kushteve dhe standardeve të ofrimit të shërbimit publik në zyrat e aplikimit të **Identitek SHA**.
2. Propozuar dhe përditësuar Ligj 8952, datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik dhe digjital të shtetasve shqiptarë” i ndryshuar. Botuar ndryshimi në fletoren zyrtare.
 - Qëllimi i këtij amendimi është ristrukturimi juridik dhe reflektimi i zhvillimeve teknologjike në përdorimin e identitetit digjital nga shtetasit shqiptarë.
3. Përditësim i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 93, datë 27.5.2024 "Për përcaktimin e procedurës dhe të dokumentacionit që paraqitet për aplikimin dhe pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike të zakonshme".

Per vitin 2026, IdentiTek do të ndërmarrë këto nisma:

1. Propozuar për vlerësim dhe mendim në Ministrinë e Punëve të Brendshme është edhe Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e të dhënave teknike mbi përdorimin dhe funksionalitetin e letërnjoftimit digjital”
 - Qëllimi i këtij projekt-vendimi është përcaktimi i parimeve të sigurisë, standardeve të integritetit dhe procedurave të menaxhimit për zbatimin e identitetit digjital të përdoruesve në Republikën e Shqipërisë, përfshirë parimet e lidhjes dhe ndërveprimit me sistemet ekzistuese shtetërore
2. Rishikim i kuadrit rregullator për leshimin e lejeve të qëndrimit për të huajt.

- Nisëm e përbashket me institucionet përgjegjëse për kufirin dhe migracionin me qëllim përditësimin e kuadrit rregullator në funksion të përmirësimit të shërbimit publik.
- 3. Propozuar për t'u përfshirë në Planin Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme për vitin 2026: Vendim i Këshillit të Ministrave “Për formën, modelin e dokumentit të identitet dhe menyra e shpërndarjes.

4. KPI 6. Marrja dhe ruajtja e certifikimit ISO (Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim)

Shoqëria e konsideron këtë Certifikim prestigjioz në një kohë rekord si një nga arritjet më domethënëse përgjatë vitit 2024. ISO 27001:2022 është Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim i cili përcakton kontrollet e sigurisë që një shoqëri duhet të zbatojë për t'u certifikuar në përputhje me udhëzimet dhe praktikën më të mira për zbatimin e një Sistemi Menaxhimi të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Ky standard ofron një qasje sistematike për menaxhimin e informacionit të ndjeshëm të një organizate, duke siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe dispozicionin e tij. Për të mbajtur certifikimin ISO 27001 një Shoqëri duhet të plotësojë vazhdimisht kërkesat e këtij standardi, duke përfshirë zbatimin dhe mbajtjen e politikave, procedurave dhe kontrolleve të forta të sigurisë së informacionit.

Ky certifikim demonstroi një përkushtim për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm, siç janë të dhënat personale dhe të dhënat e biznesit të konfidencialshme, nga kërcënime dhe vulnerabilitete të ndryshme. Për të njëjtat arsye është e domosdoshme vijimi i mbajtjes së këtij standardi për periudhën në vazhdim. IdentiTek mori certifikimin e parë ISO në gusht 2024 dhe në korrik 2025 rikonfirmoi këtë certifikim.

5. KPI 7. Numri i projekt propozimeve të hartuara me synim zhvillimin e aplikacioneve apo produkteve të reja

5.1 Projekti “Identiteti Digjital për Shtetasit Shqiptarë”

Projekti “Identiteti Dixhital për Shtetasit Shqiptarë” është një nismë kyçe brenda Strategjisë Ndërsektoriale “Afhenda Dixhitale e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit 2022-2026”, e miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 370, datë 1.6.2022. Ky projekt synon të harmonizojë zhvillimet dixhitale të Shqipërisë me Rregulloren e Parlamentit Evropian nr. 910/2014 dhe të Këshillit Evropian të datës 23 Korrik 2014 mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike (eIDAS), si dhe ndryshimet e saj nëpërmjet Rregullores së Parlamentit Evropian 2024/1183, e njohur ndryshe si eIDAS 2.0. Në këtë kontekst, projekti fokusohet në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të identitetit dixhital për qytetarët shqiptarë.

Projekti është përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duke theksuar angazhimin e qeverisë për të modernizuar infrastrukturën dixhitale dhe për të përmbushur standardet ndërkombëtare për identifikimin elektronik. Implementimi i këtij projekti përshin

zhvillimin e një platforme të avancuar për menaxhimin e identiteteve dixhitale, që do të ofrojë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për transaksionet elektronike. Kjo iniciativë do të ndihmojë në fuqizimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike dhe private në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt.

Ky investim synon të krijojë një sistem identifikimi dixhital të standardizuar dhe të besueshëm, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve elektronike në Shqipëri. Me anë të këtij projekti, Shqipëria synon të përmirësojë integrimin e saj në tregun e përbashkët evropian dhe të lehtësojë aksesin e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime ndërkufitare. Projekti gjithashtu mbështet objektivat e dixhitalizimit të qeverisjes, duke promovuar transparencën dhe reduktimin e burokracisë.

Përmes harmonizimit me rregulloret evropiane dhe implementimit të teknologjive të reja, ai synon të sigurojë një shërbim të besueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë qytetarët. Kjo nismë do të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe do të rrisë besimin në shërbimet dixhitale, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Shoqëria, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme është në hapat përgatitore për nisjen e këtij projekti transformues, i cili do të zhvillohet në faza, duke garantuar një implementim të kujdesshëm dhe të kontrolluar.

5.2 Projekti “Karta e Identitetit e Shpejtë”

Prodhimi i Kartës së Identitetit me Procedurë të Shpejtë (Fast ID) është një produkt i ri i IdentiTek, i lançuar në Mars 2025, që ka tërhequr vëmendje të gjerë publike. Ky shërbim u mundëson shtetasve pajisjen me kartë identiteti brenda tre ditëve nga aplikimi.

5.3 Projekti “Kuponi Elektronik E-Kuponi”

Kuponi elektronik (e-kuponi) është vlerësuar si një nga risitë më të rëndësishme teknologjike të IdentiTek, duke tërhequr vëmendjen e shtetasve dhe institucioneve shtetërore.

Ky shërbim, i lançuar në prill 2025, u mundëson qytetarëve të blejnë dhe të paguajnë online tarifat për kartën e identitetit dhe pasaportën, si në Shqipëri ashtu edhe përmes përfaqësive diplomatike.

5.4 Projekti “Gjurmo Dokumentin e Identifikimit”

Tani qytetarët kanë mundësinë të kontrollojnë online, në çdo moment, ecurinë e dokumentit të tyre përmes kodit unik të aplikimit <https://gjurmo.identitek.al/>.

Që nga pranimi i kërkesës, përmes procesit të prodhimit e deri në momentin e tërheqjes së dokumentit, çdo hap është i qartë dhe transparent.

Kjo risi e lehtëson maksimalisht qytetarët, duke kursyer kohë, shmangur pritjet e panevojshme dhe duke ofruar informim të menjëhershëm dhe të sigurt.

5.5 Projekti “Nënshkrimi Elektronik E-Signature”

Projekti e-Signature në përfaqësitë diplomatike ka përgjysmuar kohën e dërgimit të dokumenteve biometrikë, duke përmirësuar përvojën e qytetarëve të diasporës përmes shërbimeve më të shpejta dhe plotësisht të digjitalizuara.

Shtetasit që ndodhen jashtë vendit marrin dokumentin biometrik brenda vetëm 2 javëve, në të njëjtën kohëzgjatje si dhe në Shqipëri.

5.6 Projekti “Shërbimi i Klientit”

Që prej janarit 2025, qytetarët kanë pasur mundësi të lënë vlerësimet e tyre mbi shërbimin e marrë në zyrat e aplikimit.

Është vendosur në dispozicion një shërbim i dedikuar telefonik dhe një adresë email-i, ku qytetarët mund të drejtohen për çdo informacion apo ankesë.

Nga vlerësimet e marra gjatë muajit tetor për shërbimin e marrë në Zyrat e Aplikimit, Citizens Satisfaction Rate është 99% e tyre kanë qenë pozitive, duke na mundësuar të monitorojmë me kujdes çdo shërbim të ofruar dhe të sigurojmë standarde gjithnjë e më të larta për shtetasit

6. KPI 8. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Drejtorinë së Çelësave Publike (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, (ICAO).

Arritje madhore për IdentiTek është anëtarësimi i Shqipërisë si vend pjesëmarrës në ICAO PKD nw Mars 2025. ICAO PKD është një qendër për shkëmbimin e informacionit të kërkuar për të vërtetuar dokumentet elektronike të udhëtimit të tilla si pasaportat biometrike, kartat elektronike të identitetit etj. ICAO PKD ndihmon vendet pjesëmarrëse në përmirësimin e sigurisë kufitare, në përballimin e boshllëqeve në sigurinë e sistemeve të kontrollit kufitar, luftën kundër terrorizmit dhe krimit dhe në të njëjtën kohë, përmirëson përvojën e udhëtarëve gjatë udhëtimeve. Pjesëmarrja në PKD është një kontribues i rëndësishëm në përdorimin e suksesshëm ndërkombëtar të pasaportës së shtetasve shqiptarë.

Është gjithashtu një moment historik në përpjekjet për të përmirësuar iniciativat e pasaportave elektronike në rajon dhe një kontribut i vlefshëm në përpjekjet globale për të trajtuar keqpërdorimin e pasaportave të falsifikuara.

Në dhjetor 2025, IdentiTek përmbushi me sukses përditësimin e kërkuar nga standardet e miratuara në ndryshimet e fundit të Shtojcës 9 të Rregullores 930 të ICAO-s.

Ndryshimet u miratuan nga ICAO parashikonin janarin 2026 si afat për zbatimin e këtyre standardeve.

7. Përmbledhje e Hartës Konceptuale të Indikatorëve për Vitin 2025

Qëllimi Kryesor		
Ofrimi i shërbimeve profesionale, të besueshme dhe efikase për prodhimin e dokumenteve biometrike, duke përfshirë të gjithë hapat nga aplikimi tek shpërndarja e tyre, për shtetasit shqiptarë brenda e jashtë vendit dhe shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri		
Objektivi	Indikatori	Statusi Dhjetor 2025
I. Mbajtja e një standardi të lartë për ofrim shërbimi në kohë e në mënyrë profesionale Përfshin respektimin e afateve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike si edhe ofrimin e shërbimeve me nivel të lartë ndaj qytetarëve gjatë çdo procesi aplikimi për pajisjen me dokumente biometrike.	1. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e Letërnjoftimit Elektronik brenda dhe jashtë vendit	I arritur në masën 100%
	2. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e pasaportës biometrike brenda dhe jashtë vendit	I arritur në masën 100%
	3. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e dokumentit biometrik për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri	I arritur në masën 100%
	4. Përmirësimi i bazës ligjore për të përmirësuar e standartizuar praktika	I arritur në masën 100%
	5. Mbajtja e pasqyrave financiare të shoqërisë sipas standardeve ndërkombëtare të Raportimit Financiar	<i>Raportimi i këtij indikatori do të kryhet gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 – kur të kryhet auditimi financiar nga auditi i jashtëm i shoqërisë.</i>
II. Inovacioni Teknologjik Siguron që kompania të jetë në gjendje të përdorë teknologji në mënyrë efikase për të garantuar sigurinë dhe integritetin e produkteve dhe shërbimeve të saj të saj, duke qëndruar në krye të zhvillimeve teknologjike në fushën e prodhimit të dokumenteve të identifikimit biometrik.	6. Marrja dhe ruajtja e certifikimit ISO (Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim)	I arritur në masën 100% <i>Certifikimi u mor në gusht 2024</i> <i>Kontrolli vjetor dhe ruajtja e certifikimit, u krye në korrik 2025.</i>
	7. Numri i projekt propozimeve të hartuara me synim zhvillimin e aplikacioneve apo produkteve të reja	I arritur në masën 100% 1. Projektit “ID dixhitale” Po punohet për gjetjen e zgjidhjeve teknike për zbatimin e Projektit; 2. Projekti “Karta e Identitetit e Shpejtë”; 3. Projekti “Gjurmo Dokumentin e Identifikimit”; 4. Projekti “Nënshkrimi Elektronik E-Signature”; Projekti “Shërbimi i Klientit”
III. Anëtarësimi në ICAO PKD Garanton njohjen e pasaportës biometrike shqiptare nga Drejtoria e Celësave Publikë (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO)	8. Regjistrimi dhe anëtarësimi i IdentiTek në ICAO PKD	I arritur në masën 100% <i>Regjistrimi u arrit në tetor 2024; Anëtarësimi u arrit në Mars 2025.</i> <i>IdentiTek po zbaton cdo kërkesë të ICAO-s për përmbushjen e standardeve lidhur me dokumentet biometrike</i>

